



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government
Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Anketa mbi Kënaqshmërinë e Përdoruesve 2024

Prishtinë, Mars 2025



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistike Kosova - Kosovo Agency of Statistics

Anketa mbi Kënaqshmërinë e Përdoruesve 2024

Prishtinë, Mars 2025



AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Botues: Agjencioni i Statistikës së Kosovës (ASK)
Data e botimit: Maj, 2025
© Agjencioni i Statistikës së Kosovës
Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.
Informata të shumta janë në dispozicion në internet,
ku mund të qasen përmes ueb-faqes së ASK-së:
<http://ask.rks-gov.net>

Hyrje

Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve është mjet shumë i rëndësishëm për matjen e nivelit të kënaqshmërisë së përdoruesve në mënyrë që të kemi informacion të plotë mbi nevojat e përdoruesve, nivelin e kënaqshmërisë si dhe të kemi informacion për planifikim dhe zhvillimi të statistikave për të ardhmen.

Anketa mbi kënaqshmërinë e përdoruesve 2024 është zhvilluar në mars të vitit 2025 dhe është anketa e katërt me radhë e organizuar nga ASK.

Qëllimi i kësaj ankete është që të përcaktohet kënaqshmëria e përdoruesve lidhur me cilësinë e të dhënave dhe shërbimeve të ASK-së, si dhe përcaktimi i nevojave të tyre ku duke u bazuar në përgjigjet e përdoruesve ASK të bën përmirësime në shërbimet ndaj përdoruesve duke pasur si qëllim rritjen e cilësisë së produkteve të ASK-së.

Pyetësi është shpërndarë në mënyrë elektronike ndërsa për plotësimin e Anketës shfrytëzuesit janë njoftuar me anë të emailit gjithmonë duke u bazuar në listën e përdoruesve të të dhënave statistikore. Pyetësi u dërgua me e-mail tek përdoruesit së bashku me linkun për plotësimin e pyetësit kështu që çdo përdorues i interesuar të mund të merrte pjesë në këtë anketë.

Objektivat kryesore të kësaj ankete ishin:

- Të matet ndryshimi i nivelit të kënaqësisë së përdoruesve pas veprimeve të marra pas Anketës paraprake;
- Të matet niveli i kënaqësisë së përdoruesve lidhur me produktet statistikore dhe shërbimet;
- Të konstatohet qëndrimi aktual i përdoruesve;
- Të mirren informacionet për të identifikuar mundësitë për përmirësime të mëtutjeshme, në mënyrë që të arrihen ato çka përdoruesi kërkon.

Avantazhet kryesore të plotësimit të anketës online ishin:

- Relativisht i lirë;
- Përgjigjet u morën shumë më shpejt se me metodën e pyetësit në letër;
- E lehtë për të dërguar kujtesa, etj.

Pyetësi u plotësua nga 97 përdorues dhe përmbante 21 pyetje. Në disa pjesë të pyetësit përdoruesit mund të shkruanin propozimet dhe sugjerimet e tyre mbi përmirësime të mundshme. Pyetësi i Anketës mbi kënaqshmërinë e përdoruesve mbulonte temat e mëposhtme: Karakteristikat demografike të përdoruesve, përdorimin dhe cilësinë e të dhënave statistikore, kënaqshmërinë ndaj faqes online të ASK-së, kënaqshmërinë me punonjësit dhe cilësinë e shërbimit, si dhe pyetje mbi ndjekjen e ASK-së në rrjetet sociale.

Raportin e përgatiten:

Bekim Canolli - Drejtor i Departamentit të Metodologjisë
Servete Muriqi – U.d. Shefe e Metodologjisë dhe Diseminimit
Drita Sylejmani – Zyrtare e lartë e Diseminimit

1. Rezultatet e përmbledhura

Duke u bazuar në rezultatet e Anketës së vitit 2024, përdoruesit e të dhënave statistikore përbëhen nga 50.6% meshkuj dhe 49.4% femra, duke reflektuar një balancim më të mirë gjinor krahasuar me vitin 2021. Përdoruesit më të shumtë i takojnë grup-moshës 30–49 vjeç (54.0%), të ndjekur nga ata mbi 50 vjeç (36.8%) dhe nën 29 vjeç (9.2%).

Sa i përket arsimit, shumica e përdoruesve kishin diplomë magjistrature (54.0%), pasuar nga ata me diplomë Bachelor (32.2%) dhe doktoraturë (9.2%).

Rreth 71.9% e të anketuarve kanë mbledhur të dhëna përmes faqes zyrtare të ASK-së, ndërsa qëllimet kryesore të përdorimit të statistikave ishin për informim të përgjithshëm (44.8%), monitorim dhe hartim të politikave (28.1%), analiza tregu (22.9%) dhe hulumtime shkencore (19.8%).

Në aspektin e shpeshtësisë së përdorimit, 28.7% i përdorin të dhënat një herë në javë, 19.5% një herë në muaj, dhe 13.8% çdo ditë. Fushat më të kërkuara të statistikave ishin: Çmimet (35.4%), Tregu i Punës (30.2%), dhe Arsimi (30.2%).

Në lidhje me faqen e internetit të ASK-së, 20.8% e vizitojnë atë çdo javë, ndërsa 17.7% çdo muaj. Përdorimi i kalendarit të publikimeve është bërë nga 54.2% e përdoruesve.

Megjithëse shumica e përdoruesve shprehën kënaqshmëri të moderuar ose të lartë, ka ende hapësirë për përmirësim në përmbajtje, shpërndarje statistikash, dhe ndërtimin teknik të web faqes. Për shembull, përqindja e atyre që nuk e përdorin fare faqen zyrtare është rritur në 13.5%, dhe vetëm 48.4% kanë përdorur të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë 2024.

Kënaqshmëria e përdoruesve është matur duke bazuar në vlerësimin e ASK-së në përgjithësi, duke përfshirë plotësimin e nevojat të përdoruesve, cilësinë e të dhënave, krahasueshmërinë në kohë, besueshmërinë, si dhe sa lehtë gjinden të dhënat. Pastaj është matur niveli i kënaqshmërisë për vlerësimin e web faqes së ASK-së, vlerësimi i kënaqshmërisë me kontaktet me punonjësit, si dhe vlerësimi me shërbimet e ASK-së.

Vlerësimi i kënaqshmërisë është kryer me shkallë nga 1 deri në 6 me këtë përshkrim:

- 1 = Nuk pajtohem aspak
- 2 = Nuk pajtohem
- 3 = Mesatarisht pajtohem
- 4 = Pajtohem
- 5 = Pajtohem plotësisht
- 6 = Nuk kam mendim

Gjinia e përdoruesve

Sipas Anketës së vitit 2024, 50.6% e përdoruesve të të dhënave statistikore ishin meshkuj, ndërsa 49.4% ishin femra. Krahasuar me vitin 2021, ku përqindja e femrave ishte 43.3% dhe e meshkujve 56.7%, vihet re një përfshirje më e balancuar gjinore.

Grupmoshat

Përdoruesit më të shumtë në vitin 2024 i takojnë grup-moshës 30–49 vjeç me 54.0%. Ata mbi 50 vjeç përbëjnë 36.8% të përdoruesve, ndërsa grupmosha nën 29 vjeç përfaqësohet me 9.2%. Kjo strukturë tregon dominim të qartë të përdoruesve të moshës së mesme.

Niveli i shkollimit

Grupi më i madh i përdoruesve kishin diplomë magjistrature (Master) me 54.0%, pasuar nga ata me diplomë universitare (Bachelor) me 32.2%, ndërsa përdoruesit me doktoraturë ishin 9.2%. Këto të dhëna tregojnë rritje të ndjeshme të përdoruesve me arsim pasuniversitar krahasuar me vitin 2021.

Qasja në të dhëna dhe burimet e informimit

Rreth 71.9% e të anketuarve kanë mbledhur të dhënat nëpërmjet faqes zyrtare të ASK-së, që vazhdon të jetë burimi kryesor i informimit. 33.4% kanë përdorur databazën ASK Data, ndërsa burime të tjera përfshijnë mediat (18.8%), emailin (13.5%) dhe rrjetet sociale (11.5%).

Qëllimet e përdorimit

Të dhënat statistikore janë përdorur kryesisht për informim të përgjithshëm (44.8%), ndjekur nga hartimi i politikave (28.1%), analiza të tregut (22.9%) dhe hulumtime shkencore (19.8%). Këto qëllime tregojnë një përqendrim të lartë në përdorime institucionale dhe akademike.

Shpeshtësia e përdorimit

28.7% e përdoruesve i përdorin të dhënat statistikore një herë në javë, 19.5% një herë në muaj, dhe 13.8% çdo ditë. Përdorimi i rregullt ka shënuar rritje krahasuar me vitin 2021, duke treguar interes në rritje për përdorimin aktiv të statistikave.

Fushat më të kërkuara të statistikave

Fushat më të kërkuara në vitin 2024 ishin:

- Çmimet (35.4%)
 - Tregu i Punës (30.2%)
 - Arsimi (30.2%)
 - Demografia dhe migracioni (29.2%)
 - Kushtet e jetesës (25.0%)
-

Kënaqshmëria me cilësinë dhe paraqitjen e të dhënave

- 39.6% e përdoruesve janë pajtuar që cilësia e përgjithshme e të dhënave është e kënaqshme.
- 37.5% janë mesatarisht të kënaqur.
- 13.5% janë pajtuar plotësisht.

Vlerësimet më të larta u regjistruan për kuptueshmërinë dhe thjeshtësinë e paraqitjes së të dhënave.

Vlerësimi i faqes zyrtare të ASK-së

Përdorimi i faqes zyrtare është bërë kryesisht çdo javë (20.8%), çdo muaj (17.7%) dhe çdo ditë (14.6%). Përkundër kësaj, 13.5% e të anketuarve thanë se nuk e vizitojnë fare faqen.

Rreth 54.2% kanë përdorur Kalendarin e Publikimeve, krahasuar me 62.7% në vitin 2021, duke shënuar një rënie.

Kontaktet me punonjësit dhe shërbimet

Përdoruesit janë përgjithësisht të kënaqur me kontaktet me punonjësit:

- 50.7% i konsiderojnë punonjësit si profesionistë të mirë.
 - 44.8% mendojnë se kontakti me ta është i lehtë.
 - 59.7% janë të kënaqur me cilësinë e përgjigjeve, ndërsa 61.2% vlerësojnë informacionin nga rrjetet sociale.
-

2. Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë 2024

Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë së përdoruesve është matur me anë të këtyre shtyllave:

1. **Kënaqshmëria e web faqes së internetit të ASK-së** - vlerësimi mesatar **3.9**
2. **Kënaqshmëria me cilësinë e produkteve statistikore** - vlerësimi mesatar **4.0**
3. **Kënaqshmëria e statistikave në përgjithësi** - vlerësimi mesatar **4.1**
4. **Kënaqshmëria me punonjësit e ASK-se** - vlerësimi mesatar **3.7**
5. **Kënaqshmëria me shërbimet e statistikore** - vlerësimi mesatar **3.8**
6. **Kënaqshmëria me cilësinë e përgjithshme të të dhënave dhe shërbimeve të ASK-së** - vlerësimi mesatar **3.4**

Niveli i kënaqshmërisë është matur si mesatare e të gjitha kritereve të përshkruara me sipër.

Fig. 1: Modeli për matjen e kënaqshmërisë së përgjithshme të përdoruesve të ASK-së




Figura e mëposhtme paraqet krahasimin e nivelit të kënaqshmërisë së katër anketave të fundit.

Në krahasim me anketën e vitit 2021, të dhënat e vitit 2024 tregojnë rritje të lehta në disa fusha. Kënaqshmëria me faqen e internetit të ASK-së ka shënuar rritje pikësh (nga 3.4 në 3.9), ndërsa kënaqshmëria me cilësinë e produkteve statistikore është rritur (nga 3.9 në 4.0). Po ashtu, vërehet një qëndrueshmëri në kënaqshmerinë me shërbimet statistikore dhe statistikatat në përgjithësi, që kanë mbetur në nivelin 3.8. Nga ana tjetër, kënaqshmëria me punonjësit e ASK-së ka pësuar një ulje të lehtë prej (nga 3.8 në 3.7).

Për sa i përket cilësisë së përgjithshme të të dhënave dhe shërbimeve të ASK-së, kjo fushë mbetet e qëndrueshme në nivelin 3.4, njësoj si në vitin 2021.


Në përmbljedhje, rezultatet e vitit 2024 tregojnë një përmirësim të ndjeshëm në aspektin e qasjes në internet dhe në cilësinë e produkteve, ndërsa shumica e fushave kanë mbetur në nivele të ngjashme me ato të vitit paraprak.

Fig. 2: Niveli i përgjithshëm i kënaqshmërisë si dhe kënaqshmëria sipas kriterëve 2017, 2019, 2021, 2024



Më poshtë janë prezantuar rezultatet e nivelit të kënaqshmërisë së përdoruesve të kombinuar me karakteristikat demografike të përdoruesve.

Fig. 3: Niveli i kënaqshmërisë së përdoruesve sipas gjinisë 2017, 2019, 2021, 2024




Për sa i përket përfaqësimit gjinor të pjesëmarrësve, në vitin 2024 është vërejtur një rritje e pjesëmarrjes së femrave, nga 43.3% në 49.4%, ndërsa pjesëmarrja e meshkujve ka rënë nga 56.7% në 50.6%.

Sipas gjinisë, në këtë anketë krahasuar me anketën e kaluar, niveli i kënaqshmërisë për femra ka mbetur i njëjtë në 3.7, ndërsa për meshkuj është rritur me 0.1 pikë (nga 3.6 në 3.7).

Kjo tregon një balancim më të mirë gjinor të përdoruesve që kanë marrë pjesë në vlerësimin e shërbimeve dhe të dhënave të ASK-së krahasuar me vitin e kaluar.

Edhe pse përqindja e pjesëmarrësve sipas gjinisë ka ndryshuar krahasuar me vitin 2021, niveli i kënaqshmërisë është llogaritur mbi bazën e përgjigjeve të dhëna. Prandaj, rritja apo qëndrueshmëria e mesatares reflekton cilësinë e përvojës së përdoruesve dhe jo vetëm sasinë e tyre.

Fig. 4: Niveli i kënaqshmërisë të përdoruesve sipas nivelit të edukimit 2017, 2019, 2021, 2024



Kategoria "arsim i mesëm i lartë" është paraqitur për herë të dytë në këtë anketë dhe ka shënuar një nivel të kënaqshmërisë prej 3.9, që paraqet një rënie prej 0.1 krahasuar me vitin 2021.


Krahasuar me anketën e mëparshme, niveli i kënaqshmërisë ka rënë në të gjitha kategoritë tjera të arsimit. Tek përdoruesit me arsim bachelor/arim të lartë universitar kemi rënie prej 0.2 pikësh (nga 3.7 në 3.5), ndërsa për ata me diplomë master gjithashtu një rënie prej 0.2 pikësh (nga 3.6 në 3.4).

Kënaqshmëria te përdoruesit me doktoraturë ka pësuar rënie prej 0.1 pikësh (nga 3.7 në 3.6), duke reflektuar një prirje të përgjithshme në uljen e kënaqshmërisë krahasuar me vitin 2021 në të gjitha nivelet e arsimit.

3. Rezultatet e Anketës së Kënaqshmërisë së Përdoruesve 2024


ASK gjithmonë duke u bazuar në transparencën që ka lidhur me përdoruesit e të dhënave statistikore në këtë raport publikon të dhënat e kësaj Ankete edhe për secilën pyetje veç e veç që ju si përdorues të këtyre të dhënave të jeni sa më të informuar lidhur se sa ju jeni të kënaqur me shërbimet e ASK-së duke pasur parasysh vërejtje, komentet dhe sugjerimet e juaja të cilat janë më se të nevojshme për përmirësimin e shërbimeve tona në të ardhmen.

Fig. 5: Grupi i përdoruesve (%)



Grupi i përdoruesve që më së tepërmi i përdorin të dhënat statistikore në vitin 2024 i përkasin administratës publike me 53.1%, që paraqet rritje të ndjeshme krahasuar me vitin 2021. Më pas vijnë gazetatat dhe mediat me 9.4%, kërkuesit shkencorë me 8.3%, ndërsa bizneset kanë rënë në 6.3%. Po ashtu, përqindje të njëjtë prej 6.3% kanë edhe organizatat joqeveritare dhe përdoruesit privat. Organizatat ndërkombëtare përfaqësohen me 4.2%, ndërsa përqindja e studentëve ka rënë në 2.1%. Kategoria 'tjetër' përfshin gjithashtu 2.1% të përdoruesve.

Fig. 6: Gjinia e përdoruesve (%)




Sipas gjinisë së përdoruesve në vitin 2024, 50.6% e tyre ishin meshkuj dhe 49.4% femra.

Nëse krahasojmë të dhënat e viteve 2021 dhe 2024, vihet re një ndryshim i dukshëm në përfaqësimin gjinor. Në vitin 2021, 43.3% e të anketuarve ishin femra dhe 56.7% meshkuj, ndërsa në vitin 2024 përqindja e femrave është rritur në 49.4%, dhe ajo e meshkujve ka rënë në 50.6%.

Ky ndryshim tregon një përfshirje më të balancuar gjinore dhe një rritje të vazhdueshme të pjesëmarrjes së femrave në përdorimin e të dhënave statistikore.

Fig. 7: Grup - mosha e përdoruesve (%)




Në anketën e vitit 2024, shumica e përdoruesve i përkasin grup-moshës 30–49 vjeç me 54.0%, të ndjekur nga ata mbi 50 vjeç me 36.8%, ndërsa grup-mosha nën 29 vjeç përfaqësohet me 9.2%.

Në krahasim, në vitin 2021 përdoruesit më të shumtë po ashtu i përkisnin grup-moshës 30–49 vjeç (43.3%), ndërsa grup-moshat nën 29 vjeç dhe mbi 50 vjeç kishin pjesëmarrje të barabartë me nga 28.4%.

Këto të dhëna tregojnë se struktura sipas moshës ka mbetur e ngjashme mes dy anketimeve, me dominim të qartë të grupit 30–49 vjeç. Megjithatë, vihet re një rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes nga grup-mosha mbi 50 vjeç dhe një rënie e theksuar të grup-mosha nën 29 vjeç, krahasuar me vitin 2021.

Fig. 8: Niveli më i lartë i shkollimit të përdoruesve (%)




Sipas nivelit të shkollimit, në vitin 2024, 54.0% e përdoruesve kishin diplomë magjistrature (Master), 32.2% kishin diplomë Bachelor, dhe 9.2% kishin përfunduar studimet e doktoraturës. Ndërkohë, 3.1% ishin me arsim të mesëm të lartë, dhe 1.5% nuk kishin deklaruar nivelin e shkollimit.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2021, ku 38.8% e përdoruesve kishin diplomë Master, 34.3% diplomë Bachelor, dhe 10.4% doktoraturë, vihet re një rritje e ndjeshme e pjesëmarrjes së përdoruesve me arsim Master në vitin 2024. Po ashtu, niveli i përdoruesve me arsim të mesëm të lartë ka rënë lehtë, nga 3.7% në 3.1%.

Të dhënat e krahasuara për periudhën 2021–2024 tregojnë një trend të qëndrueshëm të përfshirjes së individëve me arsim të lartë dhe pasuniversitar në përdorimin e të dhënave statistikore.

Fig. 9: Sektori ku punojnë përdoruesit (%)




Përdoruesit e të dhënave statistikore në vitin 2024 ishin kryesisht nga sektori publik me 71.3%, të ndjekur nga sektori privat me 25.0%, ndërsa kategoritë e tjera të përdoruesve (si studentë, të papunë, pensionistë, etj.) përbënin 4.0% të përgjithshme.

Krahasuar me vitin 2021, ku 46.3% e përdoruesve ishin nga sektori publik, 41.8% nga sektori privat dhe 11.9% nga kategoritë e tjera, të dhënat e vitit 2024 tregojnë një rritje të ndjeshme të përfshirjes së sektorit publik në përdorimin e të dhënave statistikore. Në të njëjtën kohë, vihet re një rënie e përqindjes së përdoruesve nga sektori privat, si dhe ulje e ndjeshme e pjesëmarrjes nga grupet e tjera (studentë, të papunë, pensionistë, etj.).

Ky trend tregon një orientim në rritje të sektorit publik drejt përdorimit të të dhënave statistikore, ndërkohë që përdorimi nga sektori privat dhe grupet tjera ka shënuar rënie gjatë periudhës 2021–2024.

Fig. 10: Shpeshtësia e përdorimit të dhënave statistikore dhe informatave të publikuara nga ASK-ja (%)



Si rezultat i kësaj ankete, del se 28.7% e përdoruesve i përdorin të dhënat statistikore një herë në javë, 19.5% i përdorin një herë në muaj, ndërsa 13.8% i konsultojnë çdo ditë. Po ashtu, 8.2% i përdorin një herë në çdo tre muaj, ndërkohë që 14.9% i përdorin vetëm një herë në vit ose nuk kanë deklaruar se sa shpesh i përdorin.


Krahasimi i përdorimit të të dhënave statistikore ndërmjet viteve 2021 dhe 2024 tregon disa ndryshime të rëndësishme në zakonet e përdoruesve:

Në vitin 2021, 22.4% e përdoruesve raportuan se i përdorin të dhënat një herë në javë, ndërsa në vitin 2024 kjo përqindje është rritur ndjeshëm në 28.7%, duke treguar një rritje të interesimit dhe të përdorimit të rregullt të statistikave. Nga ana tjetër, përdorimi një herë në muaj ka rënë nga 26.9% në 19.5%, dhe përdorimi çdo tre muaj nga 11.9% në 8.2%.

Përdorimi i përditshëm ka mbetur pothuajse i qëndrueshëm (13.4% në 2021 dhe 13.8% në 2024). Ndërkohë, përqindja e atyre që i përdorin një herë në vit ose nuk kanë deklaruar frekuencën është rritur nga 11.9% në 14.9%.

Ky krahasim sugjeron një orientim në rritje drejt përdorimit më të shpeshtë të të dhënave statistikore, me një rënie në përdorimet më të rralla. Kjo mund të reflektojë një ndërgjegjësim më të madh për rëndësinë e statistikave në proceset e vendimmarrjes dhe planifikimit.


Fig. 11: Informimi i përdoruesve rreth të dhënave statistikore (%)
(Pyetje me përgjigje të shumëfishtë)



Në vitin 2024, shumica e përdoruesve të të dhënave statistikore të ASK-së (71.9%) i marrin informacionet nga faqja zyrtare e internetit, duke ndjekur komunikatat për shtyp dhe publikimet. 33.4% përdorin databazën statistikore, ndërsa 18.8% informohen përmes mediave tradicionale si televizioni dhe gazetatat. Burime të tjera si e-maili (13.5%), rrjetet sociale (11.5%) dhe kërkesat zyrtare (10.4%) përdoren më pak, ndërsa konferencat për shtyp mbeten burimi më pak i përdorur me vetëm 4.2%.

Krahasuar me vitin 2021, vihet re një rrënie në përdorimin e databazës statistikore, e-mailit dhe publikimeve të printuara, ndërsa faqja zyrtare vazhdon të jetë burimi kryesor i informacionit. Këto ndryshime tregojnë një kalim drejt burimeve më digjitale dhe të menjëhershme të informimit.

Fig. 12: Qëllimi i përdorimit të të dhënave statistikore (%)
(Pyetje me përgjigje të shumëfishtë)




Në vitin 2024, shumica e përdoruesve të ASK-së (44.8%) i kanë përdorur të dhënat statistikore për informim të përgjithshëm, ndjekur nga përdorimi në politika publike (28.1%), analizë tregu (22.9%), dhe hulumtime shkencore (19.8%). Më tej, të dhënat janë përdorur për ri-shpërndarje (14.6%), legjislacion (11.5%), studime dhe negociata (9.4%), biznes dhe media (6.3%), ndërsa 1.0% për qëllime të tjera.

Krahasuar me vitin 2021, vërehet një rënie në përdorimin për informim të përgjithshëm dhe analiza tregu, ndërsa ri-shpërndarja dhe përdorimet institucionale si hulumtimi dhe legjislacioni kanë mbetur të qëndrueshme ose janë rritur lehtë.

Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një rënie në përdorimet ekonomike dhe të përgjithshme, ndërsa përdorimet për qëllime shkencore, institucionale dhe rishpërndarje kanë shënuar qëndrueshmëri apo rritje të lehtë.

Fig.13: Fushat e statistikave që përdoren më së shumti (%)
(Pyetje me përgjigje të shumëfishtë)



Statistikat e përdorura më së shumti janë çmimet me 35.4%, tregu i punës me 30.2% dhe arsimi me 30.2% , Demografia dhe migracioni 29.2%, Kushtet e jetesës dhe Anketa e ekonomive familjare bujqësore me 25.0% duke vazhduar me të dhëna statistikore të tjera të paraqitura në figurë.

Krahasim i fushave më të përdorura të statistikave: 2021, 2024

Në vitin 2024, fushat më të kërkuara nga përdoruesit ishin:

- Çmimet (35.4%),
- Tregu i punës (30.2%),
- Arsimi (30.2%).


Krahasuar me vitin 2021, këto fusha kishin përqindje më të larta:

- Tregu i punës (44.6%),
- Çmimet (42.9%),
- Arsimi (30.4%).

Rënie të ndjeshme janë vërejtur në përdorimin e statistikave për tregun e punës dhe çmimet, ndërsa barazia gjinore ka shënuar rritje nga 12.5% në 20.8%.

Në përgjithësi, të dhënat e vitit 2024 tregojnë një shpërndarje më të balancuar të interesit për fusha të ndryshme statistikore, duke sugjeruar se përdoruesit po shfaqin interes më të larmishëm dhe të shpërndarë në më shumë fusha, në krahasim me vitin 2021 ku dominonin vetëm disa fusha specifike me përqindje të larta.


Fig. 14: Vlerësim i cilësisë së përgjithshme të produkteve statistikore



Sipas të dhënave të vitit 2024, përdoruesit e statistikave kanë vlerësuar më së larti këto fusha:

Arsimi dhe Anketa e ekonomive familjare bujqësore me vlerësim mesatar 3.5, Pasojnë Pagat, Demografia dhe migracioni, Çmimet, dhe Anketa strukturore e ndërmarrjeve me nga 3.3, Fusha të tjera të vlerësuara pozitivisht përfshijnë Energjinë (3.2), si dhe Barazinë gjinore, Kushtet e jetesës, Shëndetësinë, Regjistrimin e popullsisë dhe Mjedisin, të gjitha me 3.1.

Fig. 15: Përdorimi i të dhënave statistikore nga Regjistrimi i Popullsisë 2024 (%)




Sipas rezultateve të anketës, 48.4% e respondentëve kanë deklaruar se kanë përdorur të dhënat nga Regjistrimi i Popullsisë 2024, që tregon një përfshirje të konsiderueshme të përdoruesve në shfrytëzimin e këtyre të dhënave.

Ndërkohë, 39.2% kanë pohuar se nuk i kanë përdorur këto të dhëna, dhe 12.4% kanë theksuar se nuk kanë informacion të mjaftueshëm rreth tyre.

Ky rezultat tregon një nivel relativisht të mirë të përdorimit të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë, por gjithashtu evidenton nevojën për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë dhe disponueshmërinë e tyre, veçanërisht për grupin që nuk është i informuar.

Fig. 16: Qëllimi i përdorimit të të dhënave të Regjistrimit të Popullsisë, 2024



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafik, qëllimet kryesore të përdorimit të të dhënave nga Regjistrimi i Popullsisë 2024 janë të ndryshme. Përdorimi më i lartë është për politika dhe vendimmarrje (24.8%), si për planifikim urban apo strategji zhvillimore. Një përqindje e konsiderueshme e respondentëve (18.1%) kanë deklaruar se nuk i kanë përdorur fare këto të dhëna, ndërsa 16.7% i kanë përdorur për qëllime akademike, si ese apo studime universitare. Përdorime të tjera përfshijnë ato personale ose kuriozitete (14.5%), për media dhe gazetarë (14.1%), planifikim biznesi (10.1%) dhe në shkallë më të ulët për projekte të OJQ-ve (1.7%). Këto të dhëna reflektojnë një gamë të gjerë interesash dhe nevojash nga përdorues të ndryshëm.

Fig. 17: Vlerësimi i statistikave në përgjithësi (%)





Fig. 17: Vlerësimi i statistikave në përgjithësi (%) (vazhdim)




Rezultatet e anketës për vitin 2024 tregojnë se shumica e përdoruesve kanë një vlerësim pozitiv për cilësinë, qasjen dhe përdorimin e statistikave të publikuara nga ASK. Për shumicën e kategorive, alternativa "4-Pajtohem" dhe "3-Mesatarisht pajtohem" janë më të përfaqësuara, duke shënuar një nivel të kënaqshëm të besimit dhe përmbushjes së pritshmërive. Pika më e fortë është qartësia dhe mënyra e thjeshtë e paraqitjes së të dhënave, ku rreth 35% e përdoruesve pajtohen që të dhënat janë të lehta për t'u kuptuar. Gjithashtu, besueshmëria e statistikave të publikuara dhe disponueshmëria në kohë vlerësohen pozitivisht, me përqindje të larta në nivelet 4 dhe 5 të vlerësimit.

Nga ana tjetër, ka përmirësim të dukshëm edhe në aspektin e krahasueshmërisë në kohë dhe shpërndarjes së barabartë të të dhënave, megjithëse një pjesë e përdoruesve vazhdon të shfaqë hezitim (alternativa "nuk kam mendim" dhe "mesatarisht pajtohem").

Të dhënat nga viti 2024 tregojnë një trend pozitiv në perceptimin publik ndaj statistikave zyrtare, me përmirësime në thuajse të gjitha aspektet e vlerësimit, nga cilësia dhe kuptueshmëria, te besueshmëria dhe koha e publikimit. Kjo pasqyron përpjekjet e ASK-së për të rritur transparencën, qasjen dhe përdorimin e të dhënave statistikore nga publiku i gjerë.

Fig. 18: Shpeshtësia e vizitës së web faqes së internetit nga përdoruesit (%)




Sipas rezultateve të anketës së vitit 2024, 20.8% e përdoruesve deklaruan se e vizitojnë faqen zyrtare të ASK-së çdo javë, 17.7% e vizitojnë çdo muaj, 14.6% qasen çdo ditë, ndërsa 20.9% vetëm një herë në vit. Ndërkohë, 13.5% e të anketuarve thanë se nuk e vizitojnë fare ueb-faqen.

Krahasuar me vitin 2021, të dhënat tregojnë disa ndryshime të theksuara në qasje në web faqe të ASK-së: Është shënuar një rritje e lehtë e përdoruesve që qasen çdo ditë, nga 11.9% në 14.6%. Ndërsa përdorimi i përjavshëm ka rënë ndjeshëm, nga 32.8% në 20.8%. Ka rënie gjithashtu në përqindjen e atyre që qasen një herë në muaj ose një herë në çdo tre muaj. Përdoruesit që vizitojnë faqen vetëm një herë në vit janë rritur nga 17.9% në 20.9%. Ndërsa ata që nuk vizitojnë fare faqen janë rritur dukshëm, nga 1.5% në 13.5%.

Këto rezultate tregojnë një ulje të frekuencës së rregullt të qasjes, dhe një rritje të numrit të përdoruesve pasivë në vitin 2024 krahasuar me vitin 2021, çka sugjeron nevojën për nxitje dhe komunikim më efektiv me publikun për të rritur përdorimin aktiv të faqes së ASK-së.


Fig. 19: Arsyeja kryesore pse nuk i qaseni faqes së ASK-së



Bazuar në të dhënat e paraqitura në grafik, arsyeja kryesore pse përdoruesit nuk i qasen faqes së Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) është kategoria "Tjetër", e cila përfaqëson 48.5% të përgjigjeve. Pas saj, 18.2% e të anketuarve kanë deklaruar se informacioni që e kanë kërkuar nuk ishte i disponueshëm, 17.7% nuk kanë pasur nevojë ta përdorin faqen e internetit, ndërsa 15.6% kanë pasur vështirësi në përdorimin e saj.

Këto të dhëna sugjerojnë nevojën për përmirësime në qasjen, përmbajtjen dhe përdorshmërinë e faqes së ASK-së.

Fig. 20: Vlerësimi i web faqes së internetit nga përdoruesit (%)



Bazuar në të dhënat e paraqitura nga anketa për vlerësimin e faqes së internetit të ASK-së, shumica e pjesëmarrësve kanë dhënë një vlerësim pozitiv për funksionalitetin dhe përmbajtjen e faqes. Më shumë se gjysma e respondentëve janë shprehur se faqja është e ndërtuar mirë, lehtësisht e përdorshme dhe se përmbajtja si dhe aspektet teknike janë të kënaqshme.


Për shumicën e pyetjeve, përqindja më e lartë është regjistruar në shkallën 3 (mesatarisht pajtohem) dhe 4 (pajtohem), që tregon një nivel të mirë të kënaqshmërisë. Ndërkohë, një numër i pjesëmarrësve nuk pajtohen me këto vlerësime, dhe një pjesë tjetër kanë zgjedhur opsionin "nuk kam mendim", duke treguar nevojën për përmirësim të mëtejshëm në qartësi dhe funksionalitet.

Në përgjithësi, rezultatet reflektojnë një perceptim të kënaqshëm për faqen e ASK-së, por gjithashtu sugjerojnë hapësirë për përmirësime të vazhdueshme në disa fusha.

Ndërkohë, në krahasim me vitin 2021, është rritur ndjeshëm përqindja e përdoruesve që: si "Të dhënat që kërkoj gjenden lehtë", dhe "Përmbajtja e faqes është e kënaqshme".

Kategoria "Nuk kam mendim" është e qëndrueshme në të gjitha pyetjet, me një mesatare prej 5–7%, duke sugjeruar se një pjesë e përdoruesve nuk janë të njohur me funksionalitetin e web faqes.

Fig. 21: Përdorimi i kalendarit të publikimeve që është në dispozicion në faqen e internetit të ASK-së (%)




Sipas anketës së vitit 2024, 54.2% e përdoruesve deklaruan se kanë përdorur kalendarin e publikimeve të vendosur në faqen zyrtare të internetit të ASK-së, ndërsa 45.8% thanë se nuk e kanë përdorur këtë mjet.

Krahasuar me të dhënat e vitit 2021, ku 62.7% e respondentëve kishin deklaruar se e kishin përdorur kalendarin dhe vetëm 37.3% jo, vërehet një rënie në përdorimin e këtij mjeti informues.

Këto rezultate sugjerojnë një ulje të interesimit ose ndërgjegjësimit për funksionalitetin e kalendarit të publikimeve, i cili mbetet një element kyç për informimin e përdoruesve mbi publikimet statistikore. Rekomandohet që ASK të forcojë promovimin dhe dukshmërinë e kalendarit, për të nxitur përdorim më të gjerë dhe sistematik nga publiku.

Fig. 22: Kontaktet me punonjësit e ASK-së (%)




Sipas të dhënave të vitit 2024, shumica e përdoruesve shprehen pozitivisht për kontaktet me punonjësit e ASK-së. Për të gjitha kategoritë, përqindja më e lartë është te vlerësimi “3 – Mesatarisht pajtohem” dhe “4 – Pajtohem”. Nga ana tjetër, përqindja e atyre që nuk pajtohen ka rënë dukshëm në të gjitha kategoritë, ndërsa pjesa që “nuk kanë mendim” mbetet relativisht e qëndrueshme.

Këto rezultate tregojnë një përmirësim të ndjeshëm në përvojën e përdoruesve në komunikimin me ASK-në, duke reflektuar përkushtimin e stafit për ofrim të shërbimeve më efikase dhe bashkëpunuese.

Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se ka vlerësim të moderuar deri pozitiv, por edhe nevojë për rritjen e komunikimit dhe përmirësimin e qasjes ndaj përdoruesve.

Fig. 23: Shërbimet e mëposhtme nga punonjësit e ASK-së dhe shërbime tjera (%)



Të dhënat e paraqitura tregojnë një vlerësim përgjithësisht pozitiv nga përdoruesit lidhur me aspektet e ndryshme të informimit dhe komunikimit të ASK-së:


Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se shumica e përdoruesve janë të kënaqur me aspektet kryesore të komunikimit dhe përmbajtjes që ofron ASK, megjithatë ekziston hapësirë për përmirësime të mëtejshme, veçanërisht në rritjen e informimit përmes rrjeteve sociale dhe ofrimin e statistikave në formate edhe më të përshtatshme.

Megjithatë, vërehet një rritje e ndjeshme e pakënaqësisë në disa fusha, veçanërisht:

Te përmbajtja e faqes së internetit dhe mungesa e statistikave të mjaftueshme, ku është rritur ndjeshëm përqindja e vlerësimeve “2 – Nuk pajtohem” dhe “3 – Mesatarisht pajtohem”. Për këto kategori, vlerësimi i plotë “5 – Pajtohem plotësisht” është në rënie krahasuar me vitin 2021.

Këto të dhëna sugjerojnë që, përdoruesit kërkojnë përmirësime në përmbajtje, qasje dhe strukturim të të dhënave në platforma të ndryshme digjitale.

Fig. 24: Cilësia e përgjithshme të të dhënave statistikore dhe shërbimeve të ASK-së (%)



Në vitin 2024, vlerësimi i përdoruesve për cilësinë e përgjithshme të të dhënave statistikore dhe shërbimeve të ASK-së mbetet pozitiv:

- 39.6% e përdoruesve pajtohen me cilësinë,
- 37.5% mesatarisht pajtohen,
- 13.5% pajtohen plotësisht.

Vetëm një pjesë shumë e vogël shprehet në mënyrë negative:

- 2.1% nuk pajtohen, dhe
- 1.0% nuk pajtohen fare.

Krahasimi i të dhënave nga viti 2021 me ato të vitit 2024 lidhur me cilësinë e të dhënave statistikore dhe shërbimeve të ASK-së tregon një përmirësim të ndjeshëm të perceptimit të përdoruesve.

Në vitin 2021, (22.4% "pajtohem" dhe 16.4% "pajtohem plotësisht"), ndërsa në vitin 2024 kjo përqindje (39.6% "pajtohem" dhe 13.5% "pajtohem plotësisht") nga 38.8% sa ishte në vitin 2021 është rritur në 53.1% në vitin 2024.

Po ashtu, përqindja e atyre që nuk pajtohen fare ka rënë ndjeshëm nga 10.4% në 1.0%, dhe ata që nuk pajtohen nga 6% në vetëm 2.1%, duke treguar një rënie të pakënaqësisë së përgjithshme.

Megjithatë, është vërejtur një rritje të lehtë të atyre që nuk kanë mendim (nga 3.0% në 6.3%).

Në përgjithësi, të dhënat reflektojnë një rritje të besimit dhe kënaqshmërisë së përdoruesve ndaj cilësisë së të dhënave dhe shërbimeve të ASK-së në vitin 2024 krahasuar me vitin 2021.

